

VENDIM
Nr. 59, datë 29.4.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË
PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË”**

Në mbështetje të nenit 16, 20, gjerat “a” dhe “h”; nenit 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e draftkontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kushteve të përgjithshme të “Kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

2. Drejtoria Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti